



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 01.nëntor 2011  
Nr. ref.: RK 147/11

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 58/11**

Parashtruesi

**Sylë Shlivova**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës**  
**Rev. Nr. 82/2002, të 21 gushtit 2002**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është Sylë Shlivova nga fshati Jashanicë (Jošanica), Komuna e Klinës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendim i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 82/2002, i 21 gushtit 2002, me të cilin është refuzuar revizioni ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komunale të Pejës Ac. Nr. 54/2002, të 8 prillit 2002.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 82/2002, të 21 gushtit 2002, duke konsideruar se i është shkelur e drejta e punës e parashikuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

## **Baza juridike**

4. Nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56, paragrafi 2, i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 28 prill 2011.
6. Më 22 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës se është iniciuar procedura e shqyrtimit të kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 82/2002, të 21 gushtit 2002.
7. Më 4 tetor 2011, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Prof. Dr. Enver Hasani, i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

8. Parashtruesi i kërkesës ka qenë në marrëdhënie pune në Zyrën komunale në fshatin Jashanicë në periudhën prej vitit 1968 deri në vitin 1998, kur *“autoritetet serbe e përjashtuan me dhunë nga puna”*.
9. Parashtruesi i kërkesës sërish u pranua në vendin e punës si asistent në Zyrën Komunale në fshatin Jashanicë me Aktvendimin Nr. 153/99 të Këshillit Komunal të Klinës, të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, të datës 1 tetor 1999, *“për një periudhë të caktuar deri në shpalljen e konkursit”*.
10. Më 5 tetor 2000 u shpall konkursi për të gjithë punëtorët e administratës në të cilin kishte konkurruar edhe parashtruesi i kërkesës për vendin e punës asistent në Zyrën komunale në fshatin Jashanicë, mirëpo në vendin e punës ku kishte konkurruar parashtruesi i kërkesës ishte pranuar një person tjetër.
11. I pakënaqur me një vendim të tillë të komisionit të konkursit, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Komunale të Klinës për anulimin e konkursit. Parashtruesi i kërkesës në këtë padi në pjesën relevante thotë se *“është intervistuar*

nga ana e komisionit kompetent por në vendin e punës për të cilin kishte konkurruar ai ishte pranuar një person tjetër i cili nuk i ka plotësuar kushtet“.

12. Në seancën e Gjykatës Komunale të Klinës, të mbajtur më 7 dhjetor 2001, përfaqësuesit e Komunës së Klinës në përgjigjën e tyre kishin pohuar se „*padia kundër tyre ishte e pabazë, se komuna e Klinës nuk e kishte shpallur konkursin por Administrata Ndërkombëtare UNMIK-ut*“. Më tutje, ata kishin pohuar se në bazë të *Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 parashikohet imuniteti për organet e UNMIK-ut, se zyra në fshatin Jashanicë nuk ekziston më dhe se i është bashkuar zyrës në Komunën e Klinës, dhe se përfundimisht kishin kaluar të gjitha afatet brenda të cilave do të mund të kërkohej mbrojtja gjyqësore*“.
13. Gjykata Komunale e Klinës me Aktvendimin C. Nr. 89/2001, të 7 dhjetorit 2001, pas shqyrtimit të të gjitha provave e refuzoi padinë si të parashkruar për shkak se kishin kaluar të gjitha afatet prekluzive të parapara me ligjet e atëhershme në fuqi në Republikën e Kosovës dhe me rregulloret e UNMIK-ut.
14. Ndaj aktvendimit të Gjykatës Komunale të Klinës parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë, e cila me Aktvendimin Ac. Nr. 54/2002, të 8 prillit 2002, e refuzoi ankesën dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale të Klinës C.br. 89/2001, të 7 dhjetorit 2001.
15. Ndaj aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Nr. 54/2002, të 8 prillit 2002, parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës e cila me aktvendimin Rev. Nr. 82/2002, të 21 gushtit 2002, e refuzoi si të pabazuar.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 82/2002, të 21 gushtit 2002, i është shkelur e drejta e punës, e lejuar dhe parashikuar me Kushtetutë. Ai nuk përmend nenet e Kushtetutës që janë shkelur mirëpo kërkon që të kthehet në punë.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

17. Në mënyrë që të mund të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
18. Në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata Kushtetuese konstaton se parashtruesi i kërkesës ankohet në Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 82/2002, të 21 gushtit 2002. Kjo do të thotë se kërkesa ka të bëjë me ngjarje para 15 qershorit 2008, respektivisht para datës së hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në bazë të kësaj, kërkesa është dorëzuar pas afatit, dhe kësaj nuk është në përputhje „*ratione temporis*“ me dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit (shih *mutatis mutandis Jasiūnienė kundër Lituanisë, Kërkesa nr. 41510/98, Aktgjykimi i GJEDNJ-së të 6 marsit dhe 6 qershorit 2003*).
19. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (3h) të Rregullores së punës i cili parashikon që „një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: h) kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën“.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 36 (3h) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 tetor 2011, njëzëri

### VENDOS

- i. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- ii. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- iii. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**



Snezhana Botusharova



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. Dr. Enver Hasani